



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

V E N D I M

K.P.P. 606/2018

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Evis Shurdha	Kryetar
Enkeleda Bega	Nënkryetar
Vilma Zhupaj	Anëtar
Lindita Skeja	Anëtar
Merita Zeqaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 18.09.2018 shqyrtoi ankesën me:

Objekt:

“Shfuqizim i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave në lidhje me skualifikimin e operatorit ekonomik “Rozafa 94” sh.p.k në procedurën e prokurimit me Nr. Ref-70887-05-23-2018, me objekt: “Mirëmbajtje e impjanistikës (hidraulike, elektrike)”, me fond limit 916 666.00 lekë pa tvsh, zhvilluar në datën 05.06.2018, nga autoriteti kontraktor, Drejtoria Rajonale e Shëndetësisë Shkodër.

Ankimues:

“Rozafa 94” sh.p.k
Blv. “Zogu i parë”, Shkodër

Autoriteti Kontraktor:

Drejtoria Rajonale e Shëndetësisë Shkodër
Rruga “Bujar Bishanaku”, Shkodër

Baza Ligjore:

Ligji nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, neni 19/1 e vijues, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 184, datë 17.03.2010 “Për miratimin e rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, i ndryshuar.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtimet me shkrim dhe pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

V ë r e n:

I


Vlerësimi paraprak

I.1. Pas shqyrtimit paraprak të ankesës të mbështetur në dokumentacionin e dërguar nga operatori ekonomik ankimues, Komisioni i Prokurimit Publik konstatoi se ky i fundit ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të, bazuar në pikën 1 të nenit 63 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar;

I.2. Operatori ekonomik ka paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor, dhe më pas ka paraqitur ankesë, pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si organi më i lartë në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar;

I.3. Ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik;

Në këto kushte Komisioni i Prokurimit Publik mori në shqyrtim në themel objektin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues.



II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 24.05.2018 është publikuar nga autoriteti kontraktor, në faqen e internetit të Agjencisë së Prokurimit Publik, procedura e prokurimit me Nr. Ref-70887-05-23-2018, me objekt: “Mirëmbajtje e impjanistikës (hidraulike, elektrike)”, me fond limit 916 666.00 lekë pa tvsh, zhvilluar në datën 05.06.2018, nga autoriteti kontraktor, Drejtoria Rajonale e Shëndetësisë Shkodër.

II.2. Në datën 08.06.2018 operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurën e prokurimit janë njoftuar elektronikisht për klasifikimin përfundimtar të ofertave dhe ofertuesit e skualifikuar si më poshtë:

1. “Rozafa 94” sh.p.k	657.156 lekë, skualifikuar
2. “Konstruksion 04” sh.p.k	696.140 lekë, skualifikuar
3. “Nika” sh.p.k	735.979 lekë, kualifikuar
4. “Kadia” sh.p.k	776.805 lekë, kualifikuar

Operatori ekonomik “Rozafa 94” sh.p.k rezulton i skualifikuar pasi:

“Nuk ploteson kriteret tekniko-ligjore.

1-Vertetim oshee eshte jashte afatit te kerkua per te dy operatoret ekonomik.

2-Mungon kontrata e punes per ing.Sander Poja .Eshte lidhur ne mungese te noterit.

3-Mungon stafi drejtues (hidraulik dhe elektrikist).”

II.3. Në datën 14.06.2018 operatori ekonomik “Rozafa 94” sh.p.k ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor, duke kundërshtuar skualifikimin e tij në procedurën e prokurimit. Konkretisht pretendohet:

“Shoqëria është skualifikuar për motivet e mëposhtme:

1. Vertetimi oshee jashte afatit kohor të kërkuar për të dy operatorët ekonomikë.

Sqarojmë si më poshtë: Vërtetimi i OSHEE për Rozafa 94 është marrë nga furnizuesi i energjisë elektrike me datë 17.06.2018, nr. prot 1138, dhe për operatorin tjetër KGK me datë 7.5.2018, nr.prot 1054, duke përfshirë faturën korrente të muajit prill 2018. Duke patur parasysh se maturimi i energjisë elektrike të muajit maj është deri me datë 30 qershor dhe procedura e prokurimit ka qënë me datë 05.06.2018, rezulton se vërtetimi është brenda afateve të kërkuara nga ligji dhe kjo nuk mund të jetë arsye e mirëqënë për skualifikimin tonë.

2. Mungon kontrata e punes per ing.Sander Poja .Eshte lidhur ne mungese te noterit.

Sqarojmë se kontrata e punës e lidhur mes dy palëve e datës 16.06.2016, me një afat të pacaktuar, e nënshkruar nga të dyja palët e interesuara dhe e vërtetuar nga noteri me anë të autentifikimit të datës 16.06.2018, e cila vërteton nënshkrimin e tyre sipas ligjit. Si rrjedhojë ky autentifikim është në përputhje me legjislacionin në fuqi të kontratës së punës dhe nuk mund të jetë arsye për skualifikim.

3. Mungon stafi drejtues.

Sqarojmë se stafi drejtues, duke filluar nga inxhinieri i ndërtimit dhe ai elektrik, është dorëzuar licenca, diploma dhe CV-të përkatëse. Ndërsa për stafin mbështetës si hidraulik dhe elektrikist, nuk është kërkuar në mënyrë eksplicite certifikatë e kualifikimit të tyre. Operatorët ekonomikë kanë staf të kualifikuar, të vërtetuar edhe me listpagesat respektive, e deklaruar kjo nga operatorët ekonomikë me anë të formularit të vetdeklarimit të dorëzuar. ”

II.4. Nëpërmjet shkresës nr.1271/1 prot., datë 19.06.2018, autoriteti kontraktor i ka kthyer përgjigje ankimuesit, duke e pranuar pjesërisht ankesën përse i përket pikës së parë dhe të dytë. Lidhur me arsyen e tretë të skualifikimit, autoriteti kontraktor ka vendosur si vijon:

“Bashkimi i operatorëve ekonomikë “Rozafa 94” sh.p.k dhe “Karl Gega Konstruksion” sh.p.k është skualifikuar për mungesë certifikatash të stafit drejtues (specialist ndërtimi, saldator, marangoz etj.). Sipas DST – “Operatori ekonomik duhet të ketë një staf të kualifikuar për kryerjen e punimeve në të gjithë specialitetet e kërkuara .” Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave gjykon se kualifikimi i stafit dëshmohet me licenca, certifikatat e kualifikimit, trajnimit diploma etj, të cilat bashkimi i operatorëve ekonomikë nuk i ka paraqitur për asnjërin prej stafit drejtues të kërkuar në DST.”

II.5. Në datën 27.06.2018 operatori ekonomik “Rozafa 94” sh.p.k ka paraqitur ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik, duke kundërshtuar arsyen e tretë të skualifikimit.

II.6. Në datën 09.07.2018 është protokolluar në Komisionin e Prokurimit Publik me nr. 1191/2 prot., shkresa e autoritetit kontraktor nr. 1366 prot., datë 05.07.2018, me objekt: “*Informacion mbi zhvillimin e procedurës së prokurimit me objekt: “Mirëmbajtje e impjanistikës (hidraulike, elektrike”*”, bashkëngjitur informacioni e dokumentacioni mbi zhvillimin e procedurës së prokurimit dhe trajtimin e ankesës. Në procesverbalin datë 19.06.2018, të mbajtur nga Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave, konstatohet se, lidhur me ankesën e ankimuesit, ky komision ka arsyetuar si vijon:

- a. *Operatori ekonomik është skualifikuar për vërtetim OSHEE jashtë afatit kohor. Bashkimi i operatorëve ekonomikë “Rozafa 94” sh.p.k dhe “Karl Gega Konstruksion” sh.p.k kanë ngarkuar në SPE vërtetime debie nga OSHEE për Rozafa 94 nr.1138 prot., datë 17.05.2018 dhe për KGK vërtetim debie me nr. 1054 prot., datë 07.05.2018. Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave gjykon se vërtetimet janë brenda afateve të kërkuara nga ligji me 0 lekë detyrime për faturat e energjisë elektrike, përfshirë edhe faturën korente të muajit prill 2018.*
- b. *Operatori ekonomik është skualifikuar për mungesë certifikatash të stafit mbështetës (specialis ndërtimi, saldator, marangoz etj.). Sipas DST- “Operatori ekonomik duhet të ketë një staf të kualifikuar për kryerjen e punimeve në të gjithë specialitetet e kërkuara”. Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave gjykon se kualifikimi i stafit dëshmohet me licenca, certifikatat e kualifikimit, trajnimit diploma etj., të cilat operatori ekonomik nuk i ka paraqitur për stafin drejtues të kërkuar në DST.*
- c. *Operatori ekonomik është skualifikuar për kontratë jo noteriale me drejtuesin teknik (inxhinier S. P) i operatorit ekonomik Karl Gega. Karl Gega Konstruksion sh.p.k ka ngarkuar në SPE kontratën individuale të punës lidhur ndërmjet “Karl Gega Konstruksion” sh.p.k dhe zotit S.P, me datë 16.06.2018 dhe autentifikuar nënshkrimi i tyre nga noter K.R në të njëjtën datë. KSHA gjykon se kontrata ka efekt ligjor dhe ekonomik përderisa kohëzgjatja e saj është me afat të pacaktuar. Në deklaratat “Listpagesa e Sigurimeve Shoqërore Shëndetësore dhe Tatimit mbi të Ardhurat nga Punësimi” për vitin 2017 dhe periudhën janar-prill 2018, zoti S.P rezulton i punësuar i siguruar.”*

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur saj si dhe informacionit dhe dokumentacionit të autoritetit kontraktor

Arsyeton

III.1. Lidhur me arsyen e skualifikimit të operatorit ekonomik ankimues “Rozafa 94” sh.p.k, se: “Mungon stafi drejtues (hidraulik dhe elektrikist)”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.1.1. Në shtojcën 7 “Kriteret e vecanta të kualifikimit”, “Kapaciteti teknik”, pika 1 dhe 2, rezulton se nga ana e autoritetit kontraktor është parashikuar plotësimi i kërkesave si më poshtë vijon:

1.Operatori ekonomik duhet te deklarojë Drejtuesin Teknik, i cili duhet të jetë i punësuar pranë shoqërisë, i përfshirë në licensat e saj si dhe do te jetë i pranishem gjatë gjithë kohës qe do të kryhen shërbimet ne 6 (gjashtë) objekte. Deklarata të shoqërohet me CV, licencën personale dhe kontratën e punës të vlefshme.

2. Operatori ekonomik duhet të ketë nr. e nevojshëm të punonjësve për zbatimin e kontratës. Numri mesatar i punonjësve për vitin 2017 dhe periudhën Janar-Prill 2018 kërkohet të jetë jo më pak se 9 punonjës. Në këtë numër përfshihet edhe stafi drejtues. Kjo dëshmohet me një vërtetim lëshuar nga Administrata Tatimore.

Operatori ekonomik duhet të ketë një staf të kualifikuar për kryerjen e punimeve në te gjithë specialitetet e kërkuara (ndërtimore, elektrike, hidraulike etj.)

Stafi drejtues që kërkohet:

Stafi drejtues qe kerkohet:

1.	Inxhinier ndertimit me liçense.	1	Punonjes
2.	Inxhinier Elektrik	1	Punonjes
3.	Specialist+punetor ndertimi.	2	Punonjes
4.	Specialist (elektrikist).	2	Punonjes
5.	Specialist (hidraulik).	3	Punonjes

III.1.2. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të bashkimit të operatorëve ekonomikë “Rozafa 94” sh.p.k & “Karl Gega Konstruksion” sh.p.k. rezulton se është paraqitur dokumenti Kontratë për bashkëpunim të përkohshëm të shoqërive, ndërmjet shoqërisë “Rozafa 94” sh.p.k. dhe shoqërisë “Karl Gega Konstruksion” sh.p.k., në të cilën është përcaktuar ndarja e shërbimeve në përqindje, nga ku shoqëria “Rozafa 94” sh.p.k. merr përsipër 46.77 % të shërbimeve dhe shoqëria “Karl Gega Konstruksion” sh.p.k. merr përsipër 53.23 % të kontratës.

III.1.3. Nga verifikimi i ofertës së bashkimit të përkohshëm të operatorëve ekonomikë “Rozafa 94” sh.p.k & “Karl Gega Konstruksion” sh.p.k rezulton, se në përmbushje të kriterit të mësipërm, është paraqitur dokumentacioni si më poshtë:

1. Vërtetim nr.T00329128, datë 30.05.2018, lëshuar nga Drejtoria Rajonale Tatimore Shkodër, në emër të shoqërisë “Karl Gega Konstruksion” sh.p.k.
2. Deklaratë “Mbi disponueshmërinë e stafit drejtues”, lëshuar nga shoqëria “Karl Gega Konstruksion” sh.p.k.

3. Listapagesat e kontributeve të sigurimeve shoqërore, shëndetësore dhe tatimit mbi të ardhurat nga punësimi të shoqërisë “Karl Gega Konstruksion” sh.p.k.
4. Deklaratë “Mbi disponueshmërinë e stafit drejtues”, lëshuar nga shoqëria “Rozafa 94” sh.p.k.
5. Listapagesat e kontributeve të sigurimeve shoqërore, shëndetësore dhe tatimit mbi të ardhurat nga punësimi të shoqërisë “Rozafa 94” sh.p.k.

III.1.4. Në nenin 44, pika 2, të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht: *“Grupe operatorësh ekonomikë mund të dorëzojnë oferta ose të paraqiten si një kandidat i vetëm. Autoriteti kontraktor duhet t’i kërkojë një formë të veçantë ligjore bashkimit të shoqërive, për qëllim të dorëzimit të ofertës ose kërkesës për pjesëmarrje, sipas përcaktimit në rregullat e prokurimit.”*

Në nenin 46, pika 1/b, të ligjit nr.9643 dt.20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar parashikohet se : *“[...] Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret e mëposhtme, që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohet dhe jodiskriminuese: b) aftësia teknike: operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës[...].”*

Ndërsa në nenin 53/3 të LPP-së përcaktohet se: *“Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një oferte të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit.”*

III.1.5. Në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, në nenin 28, pika 5, gërmat “a”, “b”, “c”, përcaktohet: *“Për të provuar kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti kontraktor kërkon:*

- a) *licenca profesionale të shoqërisë për realizimin e punimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore; dhe/ose*
- b) *dëshmi për fuqinë punëtore të operatorit ekonomik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit; dhe/ose*
- c) *dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën”.*

Ndërs në nenin 74, pikat 1, 2 dhe 3, po këtu, është përcaktuar si vijon:

1.Oferta mund të paraqitet nga një bashkim operatorësh ekonomikë, ku njëri prej të cilëve i përfaqëson të tjerët gjatë procedurës dhe në rast përzgjedhjeje edhe gjatë zbatimit të kontratës. Në ofertë duhet të përcaktohet pjesa e shërbimit, punës ose furnizimit, që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi.

2. Para dorëzimit të ofertës, bashkimi duhet të krijohet zyrtarisht, me një marrëveshje të noterizuar, ku të përcaktohen përfaqësuesi i grupit, përqindja e pjesëmarrjes së punës/shërbimit/furnizimit dhe elementet konkrete, që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi. Pas krijimit të bashkimit të operatorëve ekonomikë, anëtarët e bashkimit caktojnë me prokurë përfaqësuesin e tyre për dorëzimin e ofertës. Kjo marrëveshje e shkruar dhe prokura duhet të dërgohen së bashku me kualifikimet dhe ofertën ekonomike, e cila duhet të nënshkruhet nga përfaqësuesi. Përfaqësuesi duhet të bëjë edhe sigurimin e ofertës, nëse kërkohet, duke specifikuar pjesëmarrjen në bashkimin e operatorëve ekonomikë. Në rast se bashkimi i operatorëve ekonomikë shpallet fitues, kontrata duhet të nënshkruhet nga secili prej anëtarëve të këtij bashkimi.
3. Secili prej anëtarëve të këtij bashkimi duhet të përmbushë kërkesat ligjore, të parashikuara në nenin 45 të LPP dhe ato të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Kërkesat ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje.

III.1.7. Referuar frymës së legjislacionit për prokurimin publik, vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t'i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Komisioni i Prokurimit Publik sqaron se është detyrim ligjor i subjektit ofertues të provojë me dokumentacion të plotë dhe në përputhje me kërkesat e autoritetit kontraktor plotësimin e kapaciteteve të kërkuara në dokumentat e tenderit, pasi ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumenta duhet të refuzohen si të papranueshme. Kriteret kualifikuese të përcaktuara nga autoriteti kontraktor, janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga të gjithë ofertuesit ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi. Autoriteti kontraktor, do të konsiderojë një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit në respekt të nenit 66 të VKM nr.914 datë 29.12.2014 i ndryshuar. Operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të vërtetojnë se zotërojnë reputacionin, besueshmërinë, kapacitetet e konsideruara të nevojshme nga autoriteti kontraktor, për të zbatuar kontratën objekt prokurimi. KPP sqaron se, në një procedurë prokurimi, subjekti i parë i interesuar është operatori ekonomik, i cili e përgatit ofertën e tij në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi, dhe nga ana tjetër, është autoriteti kontraktor, i cili përzgjedh operatorin ekonomik që plotëson të gjitha kriteret e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit, si dhe që ka përgatitur ofertën në përputhje me legjislacionin në fuqi.

III.1.8. Bazuar në sa më sipër, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se nga ana e autoritetit kontraktor, në dokumentat e procedurës së prokurimit me Nr. Ref-70887-05-23-2018, me objekt: “Mirëmbajtje e impjanistikës (hidraulike, elektrike)”, me fond limit 916 666.00 lekë pa tvsh, është

përcaktuar se kushti që operatori ekonomik duhet të ketë staf të kualifikuar për kryerjen e punimeve në të gjithë specialitetet e kërkuara (ndërtimore, elektrike, hidraulike etj.) dhe konkretisht është kërkuar staf (drejtues): 1 Inxhinier ndertimit me liçense, 1 Inxhinier Elektrik, 2 punonjes specialist + punëtor ndërtimi, 2 punonjës specialist (elektriçist) dhe 3 punonjes specialist (hidraulik), kërkesë e cila përbën detyrim ligjor për tu plotësuar nga ofertuesit e kualifikuar.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të administruar në fashikullin e shqyrtimit administrativ, parashtrimeve me shkrim të operatorit ekonomik ankimues si dhe autoritetit kontraktor rezulton se Komisioni i Vlerësimit të Ofertave ka gjykuar se bashkimit të operatorëve ekonomikë “Rozafa 94” sh.p.k. dhe “Karl Gega Konstruktion” sh.p.k. i mungon stafi drejtues (hidraulik dhe elektrikist), ndërsa sipas gjykimit të dhënë nga Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave, lidhur me këtë pikë është mbajtur qëndrimi që operatori ekonomik është skualifikuar (nga KVO-ja) për mungesë certifikatash të stafit mbështetës (specialist ndërtimi, saldator, marangoz etj.). Sipas DST- “Operatori ekonomik duhet të ketë një staf të kualifikuar për kryerjen e punimeve në të gjithë specialitetet e kërkuara”. Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave gjykon se kualifikimi i stafit dëshmohet me licenca, certifikatat e kualifikimit, trajnimit diploma etj., të cilat operatori ekonomik nuk i ka paraqitur për stafin drejtues të kërkuar në DST.

Në rastin konkret, nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur nga bashkimi i përkohshëm i shoqërive “Rozafa 94” sh.p.k. dhe “Karl Gega Konstruktion” sh.p.k. rezulton në përmbushje të kërkesës së sipërcituar të autoritetit kontraktor, shoqëria “Rozafa 94” sh.p.k. ka paraqitur deklaratën mbi disponimin e stafit drejtues në të cilin është shprehur se vë në dispozicion të objektit të mësipërm stafin drejtues dhe të kualifikuar si vijon: 1 Inxhinier ndertimit me liçense, 1 Inxhinier Elektrik, 2 punonjes specialist + punëtor ndërtimi, 2 punonjës specialist (elektriçist) dhe 3 punonjes specialist (hidraulik) si dhe ka paraqitur listapagesat e kontributeve të sigurimeve shoqërore, shëndetësore dhe tatimit mbi të ardhurat nga punësimi për periudhën janar 2017-prill 2018. Nga verifikimet e kryera në listapagesat e shoqërisë rezulton se nuk disponon asnjë punonjës me specialitetin elektrikist për të gjithë periudhën e kërkuar, ndërsa hidraulik disponon vetëm një punonjës.

Shoqëria “Karl Gega Konstruktion” sh.p.k. ka paraqitur deklaratën mbi disponimin e stafit drejtues në të cilin është shprehur se vë në dispozicion të objektit të mësipërm stafin drejtues dhe të kualifikuar si vijon: 1 Inxhinier ndertimit me liçense, 1 Inxhinier Elektrik, 2 punonjes specialist + punëtor ndërtimi, 2 punonjës specialist (elektriçist) dhe 3 punonjes specialist (hidraulik); ka paraqitur listapagesat e kontributeve të sigurimeve shoqërore, shëndetësore dhe tatimit mbi të ardhurat nga punësimi për periudhën janar 2017-prill 2018 si dhe vërtetim nr.T00329128, datë 30.05.2018, lëshuar nga Drejtoria Rajonale Tatimore Shkodër për numrin e punonjësve. Nga verifikimet e kryera në listapagesat e shoqërisë rezulton se kjo shoqëri disponon 1 punonjës me specialitetin hidraulik për të gjithë periudhën e kërkuar, ndërsa punonjësi me funksionin elektrikist figuron në listapagesa vetëm për periudhën janar 2017-korrik 2017.

Sa më lart, Komisioni i Prokurimit Publik vlerëson se dokumentacioni i paraqitur nga bashkimi i operatorëve ekonomikë “Rozafa 94” sh.p.k. & “Karl Gega Konstruktion” sh.p.k. në këtë procedurë

prokurimi, nuk plotëson kërkesat e autoritetit kontraktor për punonjës hidraulik dhe elektrikist në numrin e kërkuar në dokumentat e tenderit dhe në përputhje me përqindjen e pjesëmarrjes në shërbim të përcaktuara në aktmarrëveshjen e mësipërme, referuar së cilës, seicila prej shoqërive duhet të dispononte nga një elektrikist seicila si dhe nga 2 specialist hidraulik.

Sa më sipër, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues nuk qëndron.

Përsa më sipër, në mbështetje të nenit 19/1 dhe vijues, të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar dhe nenit 23 të VKM nr. 184, datë 17.03.2010 “Për miratimin e rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri

Vendos

1. Të mos pranojë ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Rozafa 94” sh.p.k për procedurën e prokurimit me Nr. Ref-70887-05-23-2018, me objekt: “*Mirëmbajtje e impjanistikës (hidraulike, elektrike)*”, me fond limit 916 666.00 lekë pa tvsh, zhvilluar në datën 05.06.2018, nga autoriteti kontraktor, Drejtoria Rajonale e Shëndetësisë Shkodër.
2. Autoriteti kontraktor lejohet të vijojë me hapat e mëtejshme të procedurës së prokurimit.
3. Kundër këtij vendimi, mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë.
4. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Nr. 1191 Protokoli,

Datë 27.06.2018

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nënkryetar
Enkeleda Bega

Anëtar
Vilma Zhupaj

Anëtar
Lindita Skeja

Anëtar
Merita Zeqaj

Kryetar
Evis Shurdha